





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E FINANCEVE

DATA/DATUM/DATE	18/06/2026
NR/BR.	01 Nr 132
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës Ferizaj Komitetin për Politikë dhe Financa
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit 
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim - Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029



Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore 2027/01, organizata jonë buxhetore ka hartuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029, e cila përfshin kufijtë fillestarë buxhetorë për të gjitha burimet e financimit - duke përfshirë grantet qeveritare dhe planifikimin e të hyrave vetanake - për vitin fiskal 2027, si dhe vlerësimet buxhetore për vitet 2028 dhe 2029.

Pas miratimit në parim të këtij dokumenti strategjik nga Kuvendi, do të fillojë procesi i hartimit të Projektbuxhetit për vitin 2027, si dhe i projeksioneve të hershme buxhetore për vitet 2028 dhe 2029, të cilat janë pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, në vazhdim e keni të bashkëngjitur Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, për shqyrtim dhe miratim në parim.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
2027-2029
KOMUNA FERIZAJ**

FERIZAJ
Maj 2026

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2027-2029

3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe
Financimi i Jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2027-2029

I. Hyrje


-Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 (KAB 2027-2029) paraqet dokumentin themelor të nivelit të lartë strategjik komunal, i cili reflekton projeksionet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, të strukturuar sipas kategorive ekonomike. KAB synon të sigurojë një përputhshmëri të plotë me objektivat e përcaktuara në strategjitë zhvillimore afatmesme të Komunës, duke shërbyer si udhërrëfyes për planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të financave publike.

-Ky dokument miratohet në parim çdo vit nga Kuvendi i Komunës dhe shërben si mekanizëm kyç për realizimin e objektivave prioritare të përcaktuara në dokumentet strategjike komunale. Përmes integritit të tij në procesin buxhetor, KAB siguron një lidhje të qartë midis planifikimit strategjik dhe ndarjes efektive të burimeve publike.

-Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore është një obligim ligjor për institucionet buxhetore komunale, siç përcaktohet me Qarkoren Buxhetore Komunale 2026/01, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

-KAB do të shërbejë si bazë për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit komunal dhe për identifikimin e prioriteteve në shpërndarjen e burimeve financiare për periudhën 2027-2029.

-Zhvillimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale përfshin katër faza kryesore, të cilat janë të përkrahura bashkë me afatet përkatëse kohore në figurën më poshtë:



II. Deklarata Afatmesme e Prioriteteve 2027–2029 nga Strategjia Zhvillimore Komunale

Komuna e Ferizajt gjendet në pjesën jugore të Kosovës dhe është njëra ndër komunat më të mëdha dhe më dinamike të vendit. Pozita e saj gjeografike i mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, duke e bërë Ferizajn nyje të rëndësishme për zhvim ekonomik, arsimor, shëndetësor dhe infrastrukturor. Komuna e Ferizajt ka gjithsej 45 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2023, Komuna e Ferizajt ka 109,255 banorë.

Vizioni i Komunës së Ferizajt, i përcaktuar pas një procesi gjithëpërfshirës konsultativ me akterët kyç të jetës politike, ekonomike dhe sociale, është i ndërtuar mbi dokumentet strategjike afatmesme dhe afatgjata të Komunës. Ky vizion është i harmonizuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2027–2029 të Qeverisë së Kosovës, me prioritetet themelore të saj, si dhe me udhëzimet e Qarkores Buxhetore Komunale 2027/01, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Për periudhën 2027–2029, vizioni zhvillimor i Komunës së Ferizajt bazohet në një strategji të qartë dhe gjithëpërfshirëse, e orientuar drejt ndërtimit të një Ferizaj modern, të digjitalizuar, të gjelbër, funksional dhe të bashkë-qeverisur me qytetarët.

Prioritetet kryesore zhvillimore për këtë periudhë janë:

- Ofrimi i shërbimeve publike dhe administrative më efikase përmes platformës “Ferizaj Digjital”, digjitalizimit të shërbimeve komunale, arkivit kadastral, transportit urban dhe infrastrukturës nëntokësore;
- Përmirësimi i cilësisë në arsim përmes investimeve në teknologji, tabela digjitale, kabinete të teknologjisë informative, laboratorë shkencorë, biblioteka digjitale, çerdhe, shkolla dhe bursa për drejtimet deficitare;
- Përmirësimi i sistemit shëndetësor lokal përmes përfundimit të objektivit të ri të QKMF-së, ndërtimit të QMF-ve të reja, krijimit të qendrës së dytë emergjente, shërbimeve specialistike, laboratorike dhe funksionalizimit të barnatores 24-orëshe;
- Zhvillimi i ekonomisë lokale përmes fuqizimit të sektorit privat, krijimit të kushteve për investime, mbështetjes së bizneseve lokale dhe grave në biznes;
- Zhvillimi ekonomik përmes zonave të reja ekonomike, partneriteteve publiko-private dhe përfshirjes së kapitalit vendor e të diasporës;
- Zhvillimi i urbanizmit modern dhe të qëndrueshëm përmes planifikimit hapësinor, infrastrukturës rrugore, parkingjeve, gjelbërimit urban e rural dhe menaxhimit më të mirë të mjedisit;
- Zhvillimi i bujqësisë moderne dhe agrobiznesit përmes serrave smart, sistemeve alternative të ujitjes, rrugëve të arave dhe mbështetjes së prodhuesve vendorë;
- Fuqizimi i kulturës, rinisë dhe sportit përmes investimeve në stadione, palestra, liga shkollore, evente rinore e sportive dhe festivale kulturore.

Në tri vitet e ardhshme, Komuna e Ferizajt synon të konsolidojë zhvillimin e nisur dhe të avancojë projektet strategjike që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Projektet do të orientohen drejt modernizimit të shërbimeve, forcimit të ekonomisë lokale, përmirësimit të arsimit dhe shëndetësisë, zhvillimit të qëndrueshëm urban e rural dhe ngritjes së standardeve të administrimit publik.

Po ashtu, në periudhën afatmesme, Komuna synon të realizojë projekte kulturore, rinore dhe sportive që fuqizojnë jetën publike, krijojnë mundësi për të rinjtë dhe e afirmojnë Ferizajn si qendër aktive kulturore, sportive dhe shoqërore.

Një tjetër objektiv strategjik i kësaj periudhe do të jetë investimi i orientuar në përmirësimin programor dhe infrastrukturor të sistemit shëndetësor, me synimin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe lehtësimin të qasjes në kujdesin shëndetësor.

Në të njëjtën kohë, projektet infrastrukturore, urbane dhe mjedisore do të projektohen me karakter strategjik, në mënyrë që të përballojnë dinamikën e rritjes demografike dhe zhvillimin ekonomik të Komunës së Ferizajt.

Komuna jonë bazohet në shtatë fusha prioritare, të cilat përbëjnë bazamentin e zhvillimit ekonomik dhe social:

1. Shërbimet publike dhe administrata

Përmirësimi i shërbimeve administrative dhe publike-komunale do të realizohet duke e afruar administratën më shumë me qytetarin dhe duke ulur kohën e pritjes për shërbime. Synohet të arrihet përmes:

- Platformës “Ferizaj Digjital”;
- Digjitalizimit të shërbimeve komunale;
- Aplikimeve online për subvencione komunale;
- Raportimit të problemeve nga qytetarët përmes platformës online dhe aplikacionit mobil;
- Digjitalizimit të shërbimeve kadastrale komunale;
- Digjitalizimit të lejeve ndërtimore dhe urbanistike;
- Hartës digjitale të infrastrukturës nëntokësore;
- Digjitalizimit të arkivit kadastral;
- Digjitalizimit të transportit urban.

2. Arsim dhe inovacion

Nëpërmjet politikave të avancuara arsimore dhe teknologjike, synohet:

- Vendosija e tabelave digjitale SmartBoard në dhomat mësimore;
- Hapja e kabineteve të reja të Teknologjisë Informative në shkolla;
- Ndërtimi i së paku dy shkollave fillore;
- Funksionalizimi i së paku pesë çerdheve të reja;
- Rikonstruktimi i hapësirave brenda katër shkollave të mesme në formë kampusi;
- Pajisja e shkollave me laboratorë shkencorë;
- Funksionalizimi i sistemit digjital të menaxhimit të bibliotekave;
- Krijimi i Qendrës Burimore për fëmijë me nevoja të veçanta;
- Rritja e bursave për studentët e drejtimeve deficitare.

3. Shëndetësia lokale

Komuna e Ferizajt do të vazhdojë përpjekjet për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe qasjes më të lehtë për qytetarët përmes:

- Përfundimit të ndërtimit të objektit të ri të QKMF-së;
- Pajisjes së QKMF-së me teknologji, aparaturë dhe laboratorë modernë;
- Ndërtimit të një QMF-je të re në qytet;
- Krijimit të qendrës së dytë emergjente në qytet;
- Funksionalizimit të qendrës shëndetësore specialistike;
- Zgjerimit të shërbimeve laboratorike;
- Zgjerimit të kujdesit paliativ;
- Rritjes së mbështetjes financiare për OJQ-të në sektorin e shëndetësisë;
- Zbatimit të Vertebrogramit;
- Funksionalizimit të barnatores 24-orëshe në Qendrën Emergjente.

4. Zhvillimi ekonomik, ekonomia dhe bizneset lokale

Rritja e ekonomisë komunale do të synohet përmes:

- Krijimit dhe funksionalizimit të zonave të reja ekonomike;
- Investimeve të modelit Joint Venture në Zonën e Re Ekonomike;
- Mbështetjes së sektorit privat dhe bizneseve lokale;
- Mbështetjes së bizneseve të vogla me pronare gra;
- Përfshirjes së diasporës në mundësi të reja investimi;
- Rritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

5. Infrastrukturë, zhvillim urban dhe mjedis

Komuna synon ndërtimin e një qyteti funksional, modern dhe të gjelbër përmes:

- Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe rregullores së bonuseve;
- Projektimit të zonës “Ferizaj i Ri”;
- Bulevardit të Rinisë;
- Unazës së brendshme të qytetit me studim të fizibilitetit;
- Ndërtimit të rrugës rreth Parkut të Sherretëve;
- Inicimit të projektit për ndërtimin e objektit të ri të Komunës dhe parkingut nëntokësor;
- Vazhdimin të lobimit për zgjidhjen e përhershme të çështjes së ujit të pijes;
- Mbështetjes për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- Ndërtimit të Parkut të Ri të Qytetit;
- Fushatës së gjelbërimit urban dhe rural;
- Përdorimit të teknologjisë në shërbim të qytetarit dhe mjedisit.

6. Bujqësi dhe zhvillim rural

Zhvillimi i bujqësisë moderne dhe zhvillimit rural do të synohet përmes:

- Zhvillimit të agrobiznesit dhe bujqësisë moderne;
- Serrave smart familjare dhe serrave të digjitalizuara;
- Krijimit të sistemeve alternative për ujitje;
- Vazhdimin të rregullimit të rrugëve të arave;
- Mbështetjes së fermerëve për bazene silazhi, sillose dhe prodhim vendor;
- Planifikimit të zonës turistike Jezerc–Burriq–Pleshinë.

7. Kulturë, rini dhe sport

Përmes politikave kulturore, rinore dhe sportive, synohet:

- Ndërtimi i kompleksit sportiv të jashtëm të shkollës model “Ahmet Hoxha”;
- Fuqizimi i ligave shkollore;
- Fillimi i ndërtimit të stadiumit të ri të qytetit “Ismet Shabani”;
- Ndërtimi i një palestere të re të sportit;
- Renovimi dhe modernizimi i Palestrës së Sporteve “Bill Clinton”;
- Ndërtimi i stadiumit ndihmës në fshatin Sazli;
- Mbështetja dhe fuqizimi i eventeve ekzistuese të rinisë dhe sportit lokal;
- Mbështetja dhe fuqizimi i festivaleve kulturore.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Edhe pse Komuna nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta në hartimin apo zbatimin e politikës makroekonomike—e cila është përgjegjësi e Qeverisë Qendrore konteksti i përgjithshëm ekonomik ka ndikim të drejtpërdrejtë në pasqyrën fiskale komunale dhe, rrjedhimisht, duhet të merret parasysh në planifikimin afatmesëm buxhetor. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është e harmonizuar me kornizën makroekonomike të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027-2029, të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentët kyç të politikës makroekonomike — si Bruto Produkti Vendor (BPV), norma e inflacionit, si dhe zhvillimet demografike — janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në projeksionet buxhetore dhe duhet të merren parasysh në mënyrë sistematike gjatë hartimit të KAB-it. Bazuar në të dhënat historike dhe zhvillimet aktuale, KASH 2027-2029 thekson se ekonomia e vendit pritet të ketë një trajektore pozitive të rritjes për periudhën 2027-2029, çka krijon një bazë të qëndrueshme për planifikim dhe investime në nivel lokal. Në këtë kontekst, Komuna e Ferizajt do të angazhohet për zbatimin dhe përshtatjen e legjislacionit përkatës me qëllim krijimin e një klime më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat, duke synuar rritjen e aktivitetit ekonomik lokal dhe, rrjedhimisht, të të hyrave vetanake komunale.

Burimet kryesore të financimit komunal janë:

1. **Grantet Qeveritare** – të ndara nga niveli qendror sipas formulave të përcaktuara me ligj dhe politikave fiskale kombëtare;
2. **Të Hyrat Vetanake** – të gjeneruara nga aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga vet Komuna;

Të hyrat e Komunës së Ferizajt nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Përmbledhja e financimit të buxhetit komunal për vitin 2027, 2028, 2029

Përshkrimi	Viti 2026	Viti 2027 Planifikim	Viti 2028 Vlersim	Viti 2029 Vlersim
Granti i përgjithshëm	21,344,474	23,375,852	25,148,319	27,137,824
Granti specifik i Arsimit	18,177,776	18,082,045	18,624,507	19,183,242
Granti specifik i Shëndetësis	4,992,290	5,027,241	5,178,058	5,333,400
Granti për qendrën rezidenciale	580,000	580,000	615,000	635,000
Financimi për Teatrin e qytetit	313,685	331,328	349,551	368,776
Të Hyrat Vetanake (THV)	7,660,269	8,705,863	8,992,070	9,456,541
Totali	53,068,494	56,102,329	58,907,505	62,114,783

Komuna e Ferizajt, financohet nga transferet qeveritare të cilat në tre vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 84.67% (mesatarja për tri vitet) të buxhetit të përgjithshëm të komunës, dhe nga të hyrat vetanake me 15.33% Pjesëmarrja në tri vitet e ardhshme është:

Viti 2027 granti qeveritar është 84.48% dhe të hyra vetanake komunale janë 15.52%

Viti 2029 granti qeveritar është 84.74% dhe të hyrat vetanake komunale janë 15.26%

Viti 2029 granti qeveritar është 84.78% dhe të hyrat vetanake komunale janë 15.22% .

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës së Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Të hyrat nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake të krahasuara në mes vitit aktual dhe qarkores buxhetore 2027/01

Përshkrimi	Viti 2026 Buxheti aktual	Të dhënat nga qarkorja e parë 2027/01	Krahasimi 2027-2026 në vlerë	Krahasimi 2027-2026 në %
Granti i përgjithshëm	21,344,474.00	23,375,852.00	2,031,378.00	9.52
Granti specifik i Arsimit	18,177,776.00	18,082,045.00	-95,731.00	-0.53
Granti specifik i Shëndetësisë	4,992,290.00	5,027,241.00	34,951.00	0.70
Granti për qendrën rezidenciale	580,000.00	580,000.00	0.00	0.00
Financimi për Teatrin e qytetit	313,685.00	331,328.00	17,643.00	5.62
Të Hyrat Vetanake (THV)	7,660,269.00	8,705,863.00	1,045,594.00	13.65
Totali	53,068,494.00	56,102,329.00	3,033,835.00	5.72

Bazuar në krahasimin e buxhetit aktual të vitit 2026 me të dhënat e Qarkores Buxhetore 2027/01, buxheti total i Komunës së Ferizajt për vitin 2027 shënon rritje krahasuar me vitin paraprak.

Në vitin 2026, buxheti total është planifikuar në vlerë prej 53,068,494 euro, ndërsa për vitin 2027 arrin në 56,102,329 euro. Kjo paraqet një rritje prej 3,033,835 euro, apo 5.72%.

Rritja kryesisht reflektohet te Granti i Përgjithshëm dhe Të Hyrat Vetanake, ndërsa ndryshimet te grantet specifike për arsim dhe shëndetësi janë më të vogla. Në përgjithësi, kjo rritje krijon hapësirë më të madhe buxhetore për realizimin e prioriteteve dhe projekteve komunale gjatë vitit 2027.

Në komunën tonë pjesa më e madhe e të hyrave vjen nga grumbullimi i taksave komunale.

Të hyrat e planifikuara nga taksat komunale për vitin 2027 janë 3,840,000.00€ në përqindje 44.11% në total të të hyrave vetanake, ndersa për vitin 2028 janë 4,030,000.00€ në përqindje 44.82% dhe vitin 2029 janë 4,370,000.00€ në përqindje është 46.22%.

-Niveli i taksave dhe pagesave tjera është e rregulluar me rregulloret dhe udhëzime administrative të cilat janë në fuqi.

TABELA dhe Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2027-2029				
Përshkrimi	Viti 2026	Viti 2027 Plan	Viti 2028 vlerësimi	Viti 2029 vlerësimi
TË HYRAT KOMUNALE-TOTALE	53,068,494.00	56,102,329.00	58,907,505.00	62,114,783.00
GRANTI QEVERTAR	45,408,225.00	47,396,466.00	49,915,435.00	52,658,242.00
TË HYRAT VETANAKE	7,660,269.00	8,705,863.00	8,992,070.00	9,456,541.00
Tatimi në pronë	3,274,540.00	3,602,276.00	3,634,325.00	3,652,496.00
Taksat komunale	3,290,000.00	3,840,000.00	4,030,000.00	4,370,000.00
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	100,000.00	120,000.00	125,000.00	135,000.00
Taksat e pajisjeve motorike	380,000.00	440,000.00	460,000.00	500,000.00
Lejet për ndërtesa	2,100,000.00	2,450,000.00	2,570,000.00	2,790,000.00
Matjet gjeodezike	250,000.00	300,000.00	315,000.00	345,000.00
Taksat tjera komunale	130,000.00	150,000.00	160,000.00	170,000.00
Taksat për legalizimin e pronës	330,000.00	380,000.00	400,000.00	430,000.00
Ngarkesat komunale	995,729.00	1,150,000.00	1,205,000.00	1,305,000.00
Të hyrat nga qiraja	130,000.00	150,000.00	158,000.00	170,000.00
Bashkë-pagesat për arsim	100,000.00	110,000.00	115,000.00	125,000.00
Bashkë-pagesat për shëndetësi	165,729.00	190,000.00	200,000.00	215,000.00
Ngarkesat tjera komunale përfshir (gjobat)	600,000.00	700,000.00	735,000.00	795,000.00
Të hyrat tjera	100,000.00	113,587.00	122,745.00	129,045.00
TRANSFERET QEVERTARE	45,408,225.00	47,396,466.00	49,915,435.00	52,658,242.00
Granti i përgjithshëm	21,344,474.00	23,375,852.00	25,148,319.00	27,137,824.00
Granti specifik për arsim	18,177,776.00	18,082,045.00	18,624,507.00	19,183,242.00
Granti specifik për Shëndetësi	4,992,290.00	5,027,241.00	5,178,058.00	5,333,400.00
Granti për qendrën rezidenciale	580,000.00	580,000.00	615,000.00	635,000.00
Granti për teatro	313,685.00	331,328.00	349,551.00	368,776.00

3.4 Politikat e reja

Komuna Ferizajt në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale sic janë:

- Respektim të ligjit/ akteve nënligjore, respektimin e procedurave ligjore e administrative, përgjegjshmëri, llogaridhënie, përkushtim, profesionalizëm, efikasitet dhe efektivitet, transparencë në vendimarrje dhe procedura ekzekutive;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, efikasitet i lart në menaxhimin e financave publike, rritje e të hyrave, shpenzim efektiv dhe efikas i burimeve financiare;
- Intensifikimi i aktiviteteve institucionale për përfitim të investimeve të huaja;
- Promovimi i potencialeve tona zhvillimore;
- Rritjen e transparencës buxhetore sidomos në aspektin e shpenzimeve;
- Hartimin e politikave në funksion të rritjes së të hyrave vetanake;
- Rritje e cilësisë së shërbimeve shëndetësore e sociale, sa me afër qytetarëve në nevojë; Synohet rritje e cilësisë së shëndetit dhe e mirëqenies së qytetarëve;
- Ngritje e cilësisë së mësimin, ngritje e cilësisë së kushteve për zhvillim të procesit mësimor, ngritje e kujdesit për personelin mësimor;
- Rritje e prodhimit, punësimit dhe të ardhurave familjare.
- Krijimi i parqeve të reja dhe zhvillimi urban përmes projekteve të gjelberta;
- Infrastrukturë fizike e teknike, mbi e nëntokësore e përshtatshme për të absorbuar kërkesat e rritura zhvillimore e jetike për një periudhë më të gjatë kohore;

3.5 Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KAB Komunale për 2027-2029, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës së re buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore, janë të bazuara në politikat dhe prioritet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Nisur nga katër (4) prioritetet tona strategjike për vitet 2027-2029, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si, të administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë e mirëqenies sociale.

Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2027-2029, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesëmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës në vitin 2026. Në sferën e realizimit të projekteve kapitale , rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me donatorët për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike.

Si rezultat Komuna e Ferizajt prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitet 2027-2029				
	Viti 2026 buxhetuar	Viti 2027 Plan	Viti 2028 Vlerësuar	Viti 2029 Vlerësuar
Numri I punëtorve	2483	2484	2484	2484
Paga dhe mëditje	23,623,853.00	24,511,608.00	24,634,166.00	24,757,336.00
Mallra dhe shërbime	11,519,945.00	12,183,659.00	14,391,227.00	15,447,577.00
Shpenzime komunale	1,010,982.00	1,457,062.00	1,530,000.00	1,644,750.00
Subvencine dhe transfere	2,500,000.00	2,550,000.00	2,720,000.00	2,820,000.00
Shpenzime kapitale	14,413,714.00	15,400,000.00	15,632,112.00	17,445,120.00
Totali	53,068,494.00	56,102,329.00	58,907,505.00	62,114,783.00

-Pagat dhe Mëditjet –Kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje është kategori ekonomike me pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimin e buxhetit me 43.69% e për vitin 2027, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori do të ketë pjesmarrje përafërsisht të barabart.

-Mallrat dhe Shërbimet –Pjesëmarrja e Kategorisë së shpenzimeve për mallra dhe shërbime është 21.72%. Përqindjet e pjesëmarrjes në shpenzimet e përgjithshme buxhetore nga kjo kategori, gjatë viteve të ardhshme kjo kategori do të ketë rritje të lehtë në vlerë.

-Shpenzimet komunale – Kjo kategori ka rritje të shpenzimeve në vitin 2027 në krahasim me vitin 2026. Pjesëmarrja e saj është 2.60% në buxhetin e vitit 2027 mirëpo kjo vlerë nuk është e mjaftueshme duke pasur parasysh ndryshimin e tarifave për energjinë elektrike, ujësjellësin dhe mbeturinat. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2027 dhe vitet e të ardhshme pritet të ketë ndryshime.

-Subvencionet –Në vitin 2027 kemi rritje të kësaj kategorie në krahasim me vitin 2026. Pjesëmarrja në buxhetin e vitit 2027 është 4.55% . Programet të cilat kanë subvencione janë:

- Zyra e Kryetarit;
- Shëndetësi dhe Mireqenie sociale;
- Kulturë, rini, sport, teatro
- Arsim dhe shkencë
- Shërbime publike
- Bujqësia dhe
- Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi.

-Investimet Kapitale - Kjo kategori e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2027 përfaqëson 27.45% të totalit të shpenzimeve buxhetore, duke u renditur si kategoria e dytë për nga niveli i pjesëmarrjes në strukturën buxhetore të Komunës. Një pjesë e konsiderueshme e investimeve kapitale planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të Komunës, të cilat në masë të madhe orientohen drejt realizimit të projekteve zhvillimore dhe përmirësimit të infrastrukturës komunale. Rritja e investimeve kapitale të financuara nga buxheti komunal parashihet të vazhdojë në mënyrë progresive nga viti në vit, duke reflektuar përkushtimin e Komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësim të kushteve të jetesës për qytetarët.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktuale të vitit 2026, planifikimi për vitin e ardhshëm 2027 si dhe vlerësimet për vitet 2028 dhe 2029.

Shpenzimet buxhetore 2026, shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike dhe programe (Viti aktual)

Programet	Viti 2026						
	Stafi	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	29	350,691.25	170,000.00	0.00	130,000.00	0.00	650,691.25
Zyra e Kuvendit komunal	41	370,440.00	22,000.00	0.00	0.00	0.00	392,440.00
Administrata dhe Personeli	45	396,299.24	2,800,000.00	756,000.00	0.00	100,000.00	4,052,299.24
Prokurimi	5	45,981.24	0.00	0.00	0.00	0.00	45,981.24
Buxhet dhe financa	36	322,658.03	700,000.00	0.00	0.00	0.00	1,022,658.03
Sherbime Publike	39	369,666.42	2,700,000.00	5,000.00	400,000.00	1,380,000.00	4,854,666.42
Infrastruktura publike	6	95,973.36	200,000.00	0.00	0.00	7,323,714.00	7,619,687.36
Zyra Komunale per Komunitete	13	121,146.86	11,000.00	0.00	0.00	0.00	132,146.86
Bujqësi, Pylltari dhe ZHR	5	47,883.80	650,000.00	0.00	600,000.00	1,000,000.00	2,297,883.80
Zhvillim Ekonomik	9	86,677.63	450,000.00	0.00	200,000.00	130,000.00	866,677.63
Kadastra dhe Gjeodezia	18	162,025.20	11,000.00	0.00	0.00	0.00	173,025.20
Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	109,442.58	350,000.00	0.00	0.00	1,215,000.00	1,674,442.58
Shëndetësi dhe MS	334	3,715,478.59	1,350,000.00	76,482.00	380,000.00	600,000.00	6,121,960.59
Sherbimet Sociale	17	132,050.88	45,000.00	6,000.00	0.00	0.00	183,050.88
Sherbimet Rezidenciale	10	94,568.06	120,000.00	30,500.00	0.00	335,000.00	580,068.06
Kulturë, Rini dhe Sport	55	553,597.02	290,485.00	0.00	200,000.00	340,000.00	1,384,082.02
Arsim dhe shkencë	1809	16,649,272.84	1,650,460.00	137,000.00	590,000.00	1,990,000.00	21,016,732.84
GJITHSEJ	2483	23,623,853.00	11,519,945.00	1,010,982.00	2,500,000.00	14,413,714.00	53,068,494.00

Shpenzimet buxhetore 2027, shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike dhe programe

Programet	Viti 2027						
	Stafi	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	29	332,000.00	170,000.00	-	150,000.00	-	652,000.00
Zyra e Kuvendit komunal	41	450,000.00	22,000.00	-	0.00	-	472,000.00
Administrata dhe Personeli	45	390,000.00	3,100,000.00	1,126,562.00	0.00	100,000.00	4,716,562.00
Prokurimi	5	46,000.00	0.00	-	0.00	-	46,000.00
Buxhet dhe financa	36	306,000.00	565,659.00	-	0.00	-	871,659.00
Sherbime Publike	39	545,000.00	2,500,000.00	20,000.00	450,000.00	1,380,000.00	4,895,000.00
Infrastruktura publike	6	70,000.00	200,000.00	-	0.00	8,200,000.00	8,470,000.00
Zyra Komunale per Komunitete	13	125,000.00	11,000.00	-	0.00	-	136,000.00
Bujqësi, Pylltari dhe ZHR	5	36,000.00	450,000.00	-	450,000.00	1,000,000.00	1,936,000.00
Zhvillim Ekonomik	9	85,000.00	400,000.00	-	300,000.00	130,000.00	915,000.00
Kadastra dhe Gjeodezia	18	160,000.00	150,000.00	-	0.00	-	310,000.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	85,000.00	300,000.00	-	0.00	1,215,000.00	1,600,000.00
Shëndetësi dhe MS	335	4,035,000.00	1,450,000.00	120,000.00	550,000.00	600,000.00	6,755,000.00
Sherbimet Sociale	17	110,000.00	45,000.00	10,000.00	0.00	-	165,000.00
Sherbimet Rezidenciale	10	100,000.00	120,000.00	30,500.00	0.00	335,000.00	585,500.00
Kulturë, Rini dhe Sport	55	550,000.00	450,000.00	-	400,000.00	340,000.00	1,740,000.00
Arsim dhe shkencë	1809	17,086,608.00	2,250,000.00	150,000.00	250,000.00	2,100,000.00	21,836,608.00
GJITHSEJ	2484	24,511,608.00	12,183,659.00	1,457,062.00	2,550,000.00	15,400,000.00	56,102,329.00

Shpenzimet buxhetore 2028, shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike dhe programe

Programet	Viti 2028						
	Stafi	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	29	333,660.00	180,000.00	-	170,000.00	-	683,660.00
Zyra e Kuvendit komunal	41	452,250.00	23,100.00	-	0.00	-	475,350.00
Administrata dhe Personeli	45	391,950.00	3,200,000.00	1,183,000.00	0.00	105,000.00	4,879,950.00
Prokurimi	5	46,230.00	0.00	-	0.00	-	46,230.00
Buxhet dhe financa	36	307,530.00	700,000.00	-	0.00	-	1,007,530.00
Sherbime Publike	39	547,725.00	3,058,646.00	21,000.00	500,000.00	1,450,000.00	5,577,371.00
Infrastruktura publike	6	70,350.00	210,000.00	-	0.00	8,000,000.00	8,280,350.00
Zyra Komunale per Komunitete	13	125,625.00	11,550.00	-	0.00	-	137,175.00
Bujqësi, Pyltari dhe ZHR	5	36,180.00	800,000.00	-	500,000.00	1,100,000.00	2,436,180.00
Zhvillim Ekonomik	9	85,425.00	550,000.00	-	300,000.00	135,000.00	1,070,425.00
Kadastra dhe Gjeodezia	18	160,800.00	100,000.00	-	0.00	-	260,800.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	85,425.00	384,681.00	-	0.00	1,280,000.00	1,750,106.00
Shëndetësi dhe MS	335	4,055,175.00	2,000,000.00	126,000.00	600,000.00	630,000.00	7,411,175.00
Sherbimet Sociale	17	110,550.00	47,250.00	10,500.00	0.00	-	168,300.00
Sherbimet Rezidenciale	10	100,500.00	126,000.00	32,000.00	0.00	357,000.00	615,500.00
Kulturë, Rini dhe Sport	55	552,750.00	600,000.00	-	400,000.00	360,000.00	1,912,750.00
Arsim dhe shkencë	1809	17,172,041.00	2,400,000.00	157,500.00	250,000.00	2,215,112.00	22,194,653.00
GJITHSEJ	2484	24,634,166.00	14,391,227.00	1,530,000.00	2,720,000.00	15,632,112.00	58,907,505.00

Shpenzimet buxhetore 2029, shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike dhe programe

Programet	Viti 2029						
	Stafi	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	29	335,329.00	200,000.00	0.00	170,000.00	0.00	705,329.00
Zyra e Kuvendit komunal	41	454,512.00	25,060.00	0.00	0.00	0.00	479,572.00
Administrata dhe Personeli	45	393,909.00	3,500,000.00	1,271,726.00	0.00	113,610.00	5,279,245.00
Prokurimi	5	46,461.00	0.00	0.00	0.00	0.00	46,461.00
Buxhet dhe financa	36	309,067.00	700,000.00	0.00	0.00	0.00	1,009,067.00
Sherbime Publike	39	550,463.00	3,400,000.00	22,575.00	500,000.00	1,648,853.00	6,121,891.00
Infrastruktura publike	6	70,701.00	227,786.00	0.00	0.00	8,924,000.00	9,222,487.00
Zyra Komunale per Komunitete	13	126,255.00	12,528.00	0.00	0.00	0.00	138,783.00
Bujqësi, Pylltari dhe ZHR	5	36,360.00	867,728.00	0.00	500,000.00	1,203,807.00	2,607,895.00
Zhvillim Ekonomik	9	85,852.00	450,000.00	0.00	300,000.00	200,000.00	1,035,852.00
Kadastra dhe Gjeodezia	18	161,604.00	108,469.00	0.00	0.00	0.00	270,073.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	85,852.00	417,263.00	0.00	0.00	1,384,960.00	1,888,075.00
Shëndetësi dhe MS	335	4,075,450.00	2,200,000.00	135,450.00	650,000.00	700,000.00	7,760,900.00
Sherbimet Sociale	17	111,102.00	51,252.00	11,287.00	0.00	0.00	173,641.00
Sherbimet Rezidenciale	10	101,002.00	136,672.00	34,400.00	0.00	380,370.00	652,444.00
Kulturë, Rini dhe Sport	55	555,513.00	650,819.00	0.00	450,000.00	389,520.00	2,045,852.00
Arsim dhe shkencë	1809	17,257,904.00	2,500,000.00	169,312.00	250,000.00	2,500,000.00	22,677,216.00
GJITHSEJ	2484	24,757,336.00	15,447,577.00	1,644,750.00	2,820,000.00	17,445,120.00	62,114,783.00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale, e paraqitur në mënyrë të detajuar, përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të buxhetit të Komunës së Ferizajt. Ndonëse kjo kategori nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, ajo ka rëndësi të veçantë në aspektin e planifikimit dhe zhvillimit strategjik të komunës.

Kategoria e investimeve kapitale, në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, paraqet potencialin më të madh për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal. Për këtë arsye, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, këto investime do të vazhdojnë të orientohen drejt krijimit të një ambienti më të favorshëm për rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës komunale.

Projektet kapitale 2027-2029

Nr.	Programi/përshkrimi	2027 Plani	2028 Vlerësimi	2029 Vlerësimi	Shpenzimet totale 2027-2029
	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme				
1	Ndërtimi i objektit të ri të Komunës dhe parkingu nëntokësor	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
2	Blerja e gjeneratorëve për nevoja të institucioneve publike të Komunës	50,000.00	55,000.00	63,610.00	168,610.00
	Totali	100,000.00	105,000.00	113,610.00	318,610.00
	Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Emergjente				-
1	Rregullimi i rrugëve dhe trotuarëve me asfalt dhe kubëza; Rr. Dëshmoret e Kombit, 12 Qershor, E. Topalli, E. e Jezercit, A. Bytyqi, F.Ratkoceri	300,000.00	350,000.00	300,000.00	950,000.00
2	Shtrurja e rrugëve me zhavor - hapja e rrugëve të reja	240,000.00	150,000.00	250,000.00	640,000.00
3	Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Ferizaj, Komogllavë, Greme, Neredime, Talinoc, Bibaj, Dardani, Mirosalë, Gaçkë, Tern, Prelez	300,000.00	400,000.00	400,000.00	1,100,000.00
4	Rregullimi i rrjetit të kanalizimeve dhe ujsjellësve në Ferizaj, Komogllavë, Greme, Neredime, Fsh. i Vjeter, Bibaj, Dardani, Rakaj, Gaçkë, Tern, Varrosh	300,000.00	370,000.00	400,000.00	1,070,000.00
5	Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në rruget: Dëshmoret e Kombit, 12 Qershor, V. Gervalla, G. B. Sylejmani, Astrit Bytyqi, Naim Beka	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
6	Rregullimi i deponive të ngurta në hapësirat publike në Ferizaj, Komogllavë, Manastircë, Neredime, Mirashë, Rahovicë.	30,000.00	30,000.00	40,000.00	100,000.00
7	Ndërtimi i vendndaljeve, pritoreve të autobusëve në rr. Epopeja e Jezercit, Hilmi Ferizi, fshatin Komogllavë, Koshare, Rakaj, Neredime, Balaj	30,000.00	30,000.00	40,000.00	100,000.00

8	Rregullimi i nyjeve (Udhëkryqeve) ne trafik	50,000.00	30,000.00	50,000.00	130,000.00
9	Ndërtimi i konstruksioneve per vendosjen e hidranteve ne Ferizaj dhe fshateret Greme dhe Komogllave	30,000.00			30,000.00
10	Ndërtimi i objektit III per nevoja të Komunës në Ferizaj në Rugen "Liman Reka"	30,000.00	30,000.00	100,000.00	160,000.00
11	Ndërtimi i infrastruktures per vendosjen e konteniereve mbitokesore dhe kompostereve ne Ferizaj ne:Rr.Deshmoret e Kombit, 12 Qershori, V. Gervalla etj	40,000.00	30,000.00	38,853.00	108,853.00
	Totali:	1,380,000.00	1,450,000.00	1,648,853.00	4,478,853.00
	Infrastruktura publike				-
1	Ndërtimi i një salle të re sportive në qytet	30,000.00	50,000.00	50,000.00	130,000.00
2	Ndërtimi i stadiumit ndihmës të futbollit në fshatin Sazli	30,000.00	150,000.00	400,000.00	580,000.00
3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Greme	200,000.00	200,000.00	300,000.00	700,000.00
4	Kanalizimi në fshatin Dubravë dhe Zaskok	50,000.00	50,000.00	120,000.00	220,000.00
5	Kolektori në fshatin Pojatë	70,000.00	200,000.00	260,000.00	530,000.00
6	Ndërtimi i rezervuarit të ujit në Nikadin	50,000.00	100,000.00	100,000.00	250,000.00
7	Ndërtimi i Kolektorit atmosferik në Fshat të Vjetër	100,000.00	100,000.00	-	200,000.00
8	Ndërtimi i infrastrukturës në zonat ekonomike në Babush, Mirash dhe Gërlicë	30,000.00	50,000.00	50,000.00	130,000.00
9	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes për persona të verbër në Neredime-Jezerc	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
10	Rikonstruimi i Qendrës Rinore dhe Kinemasë së Qytetit	50,000.00	80,000.00	100,000.00	230,000.00
11	Ndërtimi i parkut të ri të qytetit	100,000.00	300,000.00	300,000.00	700,000.00
12	Ndërtimi i "Bulevardit të Rinisë"	100,000.00	400,000.00	500,000.00	1,000,000.00
13	Ndërtimi i Unazës së Brendshme të Qytetit	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
14	Rikonstruimi i Memorialit të UÇK-së	50,000.00	100,000.00	200,000.00	350,000.00
15	Rikonstruimi i rrugës kryesore në lagjen e Malokëve në Pojatë	50,000.00	50,000.00	150,000.00	250,000.00
16	Rregullimi i tregut të Gjellbërt	50,000.00	30,000.00	30,000.00	110,000.00
17	Asfaltimi i rruges kryesore ne fshatin Papaz dhe rruget e mbetura ne Sazli	150,000.00	150,000.00	200,000.00	500,000.00
18	Asfaltimi i rrugeve ne fshatin Neredime e Eperme	150,000.00	-	-	150,000.00
19	Pjesëmarrja ne projekte me donator per investime ne qytetin e Ferizajt	50,000.00	100,000.00	200,000.00	350,000.00
20	Ndërtimi i Infrastruktures nentokesore dhe asfaltimi i rrugicave ne zonat I, II, III dhe IV ne Ferizaj	200,000.00	200,000.00	200,000.00	600,000.00

21	Ndertimi i trotuarit ne rrugen kryesore te fshatit dhe rrugeve te mbeura ne fshatin Komogllave	100,000.00	-	-	100,000.00
22	Asfaltimi i rrugicave ne Bablak dhe rrugicave te mbetura ne fsh. Tern dhe Prelez i Jerlive	150,000.00	-	-	150,000.00
23	Asfaltimi i rrugeve ne fshatin Balaj	100,000.00	100,000.00	-	200,000.00
24	Asfaltimi i rruges Zaskok Ferizaj	100,000.00	100,000.00	-	200,000.00
25	Asfaltimi i rrugeve ne fshatin Mirash	50,000.00	-	-	50,000.00
26	Ndertimi i kompleksit te varrezave te reja te Qytetit ne Fshatin e Vjeter, Ferizaj	50,000.00	100,000.00	150,000.00	300,000.00
27	Asfaltimi i rruges ne fshatin Rakaj	150,000.00	150,000.00	150,000.00	450,000.00
28	Asfaltimi i rruges kryesore ne fshatin Dremjak	80,000.00	100,000.00	100,000.00	280,000.00
29	Rikonstrumi i rrjetit te ndriqimit publik ne zonat I, II, II dhe IV dhe ne fshaterat Greme, Komogllave, Rahovice, Dradani, Sojeve Kosine	100,000.00	400,000.00	500,000.00	1,000,000.00
30	Pjesemarrja ne projekte me donatore, ujesjellesi ne fshatin Sojeve, Darrdani deh Zllatar	300,000.00	100,000.00	50,000.00	450,000.00
31	Asfaltimi me kater korsi i Rruges Cen Dugolli dhe Reçakut nga Policia deri telidhja me rr. Cen Dugolli	50,000.00	-	-	50,000.00
32	Rregullimi i kanalizimit ne fshatin Zaskok dhe asfaltimi i rrugeve ne Doganaj	30,000.00	-	-	30,000.00
33	Asfaltimi i rruges kryesore ne fshatin Cernille	100,000.00	100,000.00		200,000.00
34	Rregullimi i kyçjeve te ujesjellesit per Neredime dhe Manastirc	100,000.00	100,000.00	120,000.00	320,000.00
35	Shqyrtimet gjeomekanike për të gjitha projektet e investimeve kapitale për qytetin e Ferizajt	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
36	Asfaltimi i rrugeve ne Rahovice dhe Talinoc te Muhaxhereve	100,000.00	100,000.00	-	200,000.00
37	Asflatimi i rrugeve dhe rregullimi i trotuareve ne fshaterat Varosh, Fshat i Vjeter, Bibaj dhe Nikadin	50,000.00	150,000.00	300,000.00	500,000.00
38	Asfaltimi i rruges Gaçe Topoan Gerlice dhe rregullimi i ujesjellesit ne lagjen Bajram Curri	100,000.00	100,000.00	100,000.00	300,000.00
39	Rregullimi i parkut ne Prelez te Muhaxherve dhe ndertimi i fushes sportive ne Surqine dhe Tern	70,000.00	150,000.00	-	220,000.00
40	Ndertimi i nenkalimit per vetura dhe kembesor afer stacionit policor ne Ferizaj	1,500,000.00	-	-	1,500,000.00
41	Ndertimi i trotuarit ne fshatrat Kosine dhe Dremjak	100,000.00	50,000.00		150,000.00
42	Ndertimi i rruges Varosh Gerlice pergjate hekurudhes dhe ndertimi i mbikalimeve per kembesore	100,000.00	250,000.00	-	350,000.00

43	Rregullimi i rrjetit te demtuar te kanalizimit ne fshatrat Greme,Mirosalë, Dardani,Zllatar, etj...	200,000.00	-	-	200,000.00
44	Rregullimi i kanalizimit fekal Greme - Varosh - Gerlice	150,000.00	150,000.00	150,000.00	450,000.00
45	Rikonstruimi i rruges "Naim Beka" - Pleshine	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
46	Rikonstruimi i rruges kryesore ne fshatin Varosh	200,000.00	-	-	200,000.00
47	Rikonstruimi i rruges "Besim Rexhepi" dhe "Rizah Matoshi" ne Ferizaj	100,000.00	200,000.00	-	300,000.00
48	Rregullimi - Izolimi i ndertesave publike ne komunen e Ferizajt ne kuader te masave eficiente	45,000.00	45,000.00	45,000.00	135,000.00
49	Hapja e puseve te ujit te pijshem ne Kosine dhe rregullimi i rrjetet te ujesjellesit Kosine Dremjak	30,000.00	-	-	30,000.00
50	Asfaltimi I rrugëve të mbetura në fshatin Pleshinë	50,000.00	-	-	50,000.00
51	Rikonstruimi i rruges kryesore ne Prelez te Jerlive	70,000.00	-	-	70,000.00
52	Ndertimi dhe rregullimi i sheshit nga rrethi i rruges Madeleine Albright deri te Teatri i Qytetit	100,000.00	400,000.00	1,000,000.00	1,500,000.00
53	Rikonstruimi i rruges 12 Qershori	100,000.00	300,000.00	500,000.00	900,000.00
54	Asfaltimi i rruges nga Lagjia Spahia Greme deri ne Varosh	100,000.00	200,000.00	50,000.00	350,000.00
55	Ndertimi i kolektorit Nikadin Gerlice, faza e I-re	50,000.00	-	-	50,000.00
56	Rikonstruktimi i rruges kryesore ne fshatin Gaçke	100,000.00	150,000.00	79,000.00	329,000.00
57	Rregullimi i rrjetit te ujit te pijshem ne fshatin Rakaj	100,000.00	170,000.00	-	270,000.00
58	Ndertimi i mureve mbrojtese ne fshatrat Neredime, Dremjak, Mirosale dhe Gaçkë	70,000.00	100,000.00	-	170,000.00
59	Asfaltimi i rrugës Muhoc - Sazli	100,000.00	200,000.00	250,000.00	550,000.00
60	Asfaltimi i rrugës UÇK-së prane kazermes se FSK	100,000.00	250,000.00	250,000.00	600,000.00
61	Asfaltimi i rrugëve ne fshatrat Koshare, Lloshkobare dhe Kosinë	150,000.00	-	-	150,000.00
62	Ndertimi i ujesjellesit ne fshatin Gaçkë	70,000.00	50,000.00	50,000.00	170,000.00
63	Rregullimi i kanalizimit fekal në Prelez dhe Muhoc	200,000.00	150,000.00	150,000.00	500,000.00
64	Asfaltimi i rruges Prelez i Jerlive - Prelez i Muhaxhereve	100,000.00	200,000.00	200,000.00	500,000.00
65	Zgjerimi i rruges nga Lagjia Tafaliaj deri te shkolla në Komogllavë	100,000.00	200,000.00	200,000.00	500,000.00
66	Asfaltimi i rruges Manastirc - Pleshine	150,000.00	100,000.00	200,000.00	450,000.00

67	Asfaltimi i rruges qe lidh rrugen Naim Beka dhe rrugen Epopeja e Jezercit	100,000.00	150,000.00	150,000.00	400,000.00
68	Ndertimi i trotuarit ne Talinove të Jerlive dhe asfaltimi i rrugeve	100,000.00	150,000.00	150,000.00	400,000.00
69	Asfaltimi i rrugeve ne lagjen e Sherretve dhe Riza Matoshi	150,000.00	100,000.00	150,000.00	400,000.00
70	Rikonstruimi i rrugës "Bifurkacioni"	150,000.00	100,000.00	300,000.00	550,000.00
71	Asfaltimi i rrugës që lidh rrugën "Ismet Sopa" me unazë të jashtme	50,000.00	50,000.00	100,000.00	200,000.00
72	Ndertimi i kanaleve te ujrave atmosferik ne fshatin Tërrn	55,000.00	55,000.00	100,000.00	210,000.00
73	Asfaltimi i rrugës tek Kampusi i shkollave te mesme	50,000.00	50,000.00	100,000.00	200,000.00
	Totali:	8,200,000.00	8,000,000.00	8,924,000.00	25,124,000.00
	Bujqësi dhe Pylltari				-
1	Rregullimi i kanaleve ujëtare(xhepave përgjate lumit-sistem alternativ I ujitjes)ne fshatrat Neredime-Balaj	100,000.00	206,368.00	170,000.00	476,368.00
2	Rregullimi i tregut te kafsheve dhe ndertimi i strehimores se geneve endacak ne fshatin Muhoc	150,000.00	-	-	150,000.00
3	Hapja e kanaleve per kullimin e tokave bujqesore në fshaterat Komogllavë, Pojatë, Surqinë	150,000.00	300,000.00	300,000.00	750,000.00
4	Ndertimi i silloseve per ruajtjen e grurit në fshatin Pojatë	200,000.00	150,000.00	200,000.00	550,000.00
5	Ndertimi i qendres se panairove-hipodromi në Papaz	100,000.00	50,000.00		150,000.00
6	Ndërtimi i tregut të kafshëve në fshatin Dardani	150,000.00	150,000.00	80,000.00	380,000.00
7	Rregullimi i rrugëve te arave me zhavor	150,000.00	243,632.00	453,807.00	847,439.00
	Totali:	1,000,000.00	1,100,000.00	1,203,807.00	3,303,807.00
	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit				-
1	Ndertimi i infrastruktures se zonave turistike ne Jezerc	70,000.00	70,000.00	120,000.00	260,000.00
2	Ndertimi i infrastruktures te Ujevara ne fshatin Pleshinë	30,000.00	30,000.00	40,000.00	100,000.00
3	Ndertimi i Murit Alpin ne Jezerc	30,000.00	35,000.00	40,000.00	105,000.00
	Totali:	130,000.00	135,000.00	200,000.00	465,000.00
	Drejtoria e Urbanizmit				-
1	Zgjerimi dhe rregullimi i "Parkut Liria"	400,000.00	430,000.00	400,000.00	1,230,000.00
2	Pyllëzimi dhe rregullimi i Parkut ne "Kodren e Sherretve"	400,000.00	500,000.00	500,000.00	1,400,000.00
3	Ndertimi i parqeve te reja, (mbjellja e drunjeve dekorativ) ne Prelez, Ferizaj, Pleshine dhe Neredime	305,000.00	200,000.00	400,000.00	905,000.00

4	Rregullimi i shetitorës rreth shtratit të lumit ng Ura e Dudit deri te Ura e Islamit	30,000.00	50,000.00	50,000.00	130,000.00
5	Ndërtimi i parkut të ri në lokacionin ekzistues të ndërmarrjes Pastertia	80,000.00	100,000.00	34,960.00	214,960.00
	Totali:	1,215,000.00	1,280,000.00	1,384,960.00	3,879,960.00
	Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mireqenies Sociale				-
1	Ndërtimi i shtëpise së pensionistëve në Ferizaj	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
2	Ndërtimi I Ri I QKMF-se në Ferizaj	30,000.00	70,000.00	160,000.00	260,000.00
3	Ndërtimi i AMF-së Rakaj	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
4	Ndërtimi i QMF-se në Koshare	150,000.00	250,000.00	250,000.00	650,000.00
5	Ndërtimi i qendres rehabilituese për përdoruesit e substancave narkotike	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
6	Blerja e 10 oksigjen konzentror	30,000.00	-	-	30,000.00
7	Blerja e 3 veturave frigorifer për kujdes palativ	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
8	Ndërtimi i QMF - 12 në qytet	100,000.00	70,000.00	50,000.00	220,000.00
9	Ndërtimi i një QMF-je të re në qytet	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
10	Rikonstruimi I QMF-1 në Qendrën Emergjente dhe Specialistike	100,000.00	50,000.00	50,000.00	200,000.00
	Totali:	600,000.00	630,000.00	700,000.00	1,930,000.00
	Qendra Rezidenciale				-
1	Ndërtimi i shtëpise për mbrojtjen e fëmijëve në Ferizaj	230,000.00	230,000.00	250,000.00	710,000.00
2	Ristrukturimi i qendres rezidenciale në Ferizaj	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
3	Ndërtimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara	55,000.00	77,000.00	80,370.00	212,370.00
	Totali	335,000.00	357,000.00	380,370.00	1,072,370.00
	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport				-
1	Ndërtimi i veprave artistike skulpturore në oborrin e Pallatit të Kulturës rr.Bifurkacioni-Ferizaj	30,000.00	40,000.00	30,000.00	100,000.00
2	Ndërtimi i fushave për futboll të madh në fsh.Sazli, Saraishtë dhe Dardani	110,000.00	100,000.00	200,000.00	410,000.00
3	Renovimi i palestres së sporteve Bill Clinton në Ferizaj	30,000.00	-	-	30,000.00
4	Ndërtimi i fushave sportive në fshatrat Lloshkobare, Pleshinë, Prelez i Muhaxherëve	50,000.00	60,000.00	40,000.00	150,000.00
5	Ndërtimi i Obeliskut për Kuvendin e Ferizajt të vitit 1908 në Ferizaj	30,000.00	30,000.00	30,000.00	90,000.00
6	Ndërtimi i fushave sportive me Taraflex	50,000.00	60,000.00	40,000.00	150,000.00
7	Ndërtimi i tribunave në stadiumin Tefik Çanga në fshatin Tërrn	40,000.00	70,000.00	49,520.00	159,520.00

	Totali:	340,000.00	360,000.00	389,520.00	1,089,520.00
	Drejtoria e Arsimit				-
1	Ristrukturimi i hapësirave të shkollave të mesme në formë kampusi	200,000.00	200,000.00	200,000.00	600,000.00
2	Ndertimi i shkolles se mesme ne Ferizaj	160,000.00	-	-	160,000.00
3	Ndertimi i shkolles se re ne Neredime	100,000.00	170,000.00	-	270,000.00
4	Ndertimi I aneksit te shkolles fillore-Ish Shaban Hashani në Ferizaj	130,000.00	-	-	130,000.00
5	Ndertimi i shkolles fillore Deshmoret e Lirise ne fshatin Manastirc	50,000.00	50,000.00	300,000.00	400,000.00
6	Ndërtimi I shkollës së re në fsh. Varosh	50,000.00	30,000.00	50,000.00	130,000.00
7	Ndertimi i shkolles fillore ne fshatin Terrn	190,000.00	100,000.00	100,000.00	390,000.00
8	Ndërtimi i qerdhes së re në qytet	100,000.00	100,000.00	100,000.00	300,000.00
9	Ndërtimi i çerdheve të reja në rajonin e Grykës së Neredimes, në rajonin e Pleshinës dhe Talinoc i Muhaxherëve	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
10	Rikonstruktimi I objekteve ekzistuese shkollore në çerdhe, në fshatin Lloshkobare dhe Komogllavë	50,000.00	50,000.00	50,000.00	150,000.00
11	Ndërtimi i kompleksit për sportin shkollor në hapësirën e ish-stadiumit "Ismet Shabani"	200,000.00	300,000.00	300,000.00	800,000.00
12	Ndërtimi I sallës sportive në shkollat "Vezir Jashari", "Riza Matoshi" dhe "Afrim Abazi"	100,000.00	100,000.00	200,000.00	400,000.00
13	Ndertimi i anekseve dhe rikonstruimi i shkollave dhe sallave sportive ne shkollat Bilal Shala - Lloshkobare, Besim Rexhepi - Komogllave, Enver Topalli - Greme	400,000.00	300,000.00	500,000.00	1,200,000.00
14	Ristrukturimi I të gjitha dhomave mësimore dhe pajisja e tyre me tabela digjitale (Smart Board)	120,000.00	450,000.00	430,000.00	1,000,000.00
15	Ndertimi dhe furnizimi i kabineteve profesionale laboratorike ne shkollat Gjimnazi Shkencore dhe Shkolla e mesme e Mjekesise Elena Gjika	100,000.00	200,000.00	120,000.00	420,000.00
16	Rregullimi dhe digjitalizimi I bibliotekave shkollore si dhe furnizimi me libra	100,000.00	115,112.00	100,000.00	315,112.00
	Totali:	2,100,000.00	2,215,112.00	2,500,000.00	6,815,112.00
	Gjithësej	15,400,000.00	15,632,112.00	17,445,120.00	48,477,232.00

Kryetari i Komunës,

z.Agim Aliu